



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A.

DREJTORIA E PROKURIMIT DHE ANKANDIT

Nr. _____ Prot.

Patos më, ____ .04.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TË REFERENCËS,
SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim i ruajtjes së pronës”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT Kodi CPV: 79713000-5 - Shërbime roje/shërbime me roje,

VLERA E FONDIT LIMIT: 336,791,426.4 (treqind e tridhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e njëzet e gjashtë pikë katër) lekë pa TVSH.

Fondi limit për një vend-roje/mujore :425,241.7 (katërqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e dyzet e një pikë shtatë) (për një vend-roje me tre turne/muaj) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura nuk do të ndahet në lote.

Bazuar në nenin 39 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” parashtrijmë arsyet kryesore për vendimin e mosndarjen në lote për këtë procedurë.

Lidhur me sa më sipër sqarojmë se AK Albpetrol sha e ushtron aktivitetin në tre qarqe (Fier Vlorë Berat) dhe ka asete që kërkojnë shërbimin e ruajtjes në të tre këto qarqe.

Ndarja e procedurës në tre lote do të sillte kosto të shtuara për AK pasi për shkak të procedurave do të ndodheshim përballë faktit të nënshkrimit të tre kontratave të ndryshme me operatorë të ndryshëm dhe me afate të ndryshme të përfundimit të kontratave.

Ndërkohë Albpetrol sha e ushtron aktivitetin në këto qarqe si një shoqëri e vetme. Përgjatë një viti situata e shoqërisë është dinamike dhe për shkak të marrjes apo dorëzimit të vendburimeve të

naftës ku ushtron aktivitetin Albpetrol sha apo për shkak të ristrukturimit të shoqërisë mund të lindë nevoja e ndryshimit të vendrojeve nga njëri qark në tjetrin. Pasja e disa kontratave të lidhura me operatorë të ndryshëm nuk do ta lejonte këtë gjë dhe do ta vinte në vështirësi dhe do të shtonte kostot për AK.

Theksojmë gjithashtu se Albpetrol sha është ndodhur përballë kësaj situate në të shkuarën, pasi njëra nga kontratat që ka patur për shërbimin e ruajtjes me tre vendroje në qarkun Berat (Bashkia Kucovë) kishte mbaruar dhe gjatë gjithë periudhës së mëvonëshme Albpetrol sha u ndodh përpara faktit dhe u vu në vështirësi pasi nuk mund të ruante asetet e veta në këto vendroje deri në përfundimin e procedurës dhe lidhjen e kontratës së re për këtë shërbim.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1. Licensë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të “Shërbimit të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike”, **nënkategoria 1.3.A**, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”, lëshuar nga QKL.

2.1.2. Çertifikatë e titullarit të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A.

2.1.3. Çertifikatë e drejtuesit teknik të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A

2.1.4. Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave në baze të Ligjit nr. 75/2014, nënkategoria 1.3.A për të paktën 110(njëqind e dhjetë) punonjës shërbimi gjithsej, nga të cilat jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) punonjës shërbimi të leshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier, jo më pak se 25 (njëzet e pesë) punonjës shërbimi të leshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlore, dhe jo më pak se 25 (njëzet e pesë) punonjës shërbimi të leshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Berat.(sipas tabelës për punonjësit e shërbimit të kërkuar)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 2 e LPP, si dhe nenin 41 pika 4 gërma ”a” dhe ”b”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Këto kritere shërbejnë për të provuar se ofertuesit janë të licencuar në lidhje me këtë shërbim si dhe kanë kapacitetet profesionale për kryerjen e shërbimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vertetim nga Administrata Tatimore per xhiron vjetore te realizuar ne tre vitet e fundit 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se vlera e fondit limit objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Kopje te certifikuar te bilancit për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinat e shërbimeve të furnizuara.

OSE

Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinat e shërbimeve të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, leshuar nga Drejtorite e Vendore te Policise ku ndodhen objektet ku kryhet sherbim, ne baze te nenit 22 te Ligjit nr. 75/2014 "Per sherbimin Privat te sigurise fizike" dhe Udhezimit te Ministrit te Brendshem nr.130, date 05.03.2018 "Per funksionimin e sherbimit privat te sigurise".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", dhe shërben për të garantuar AK se ofertuesi i ka kapacitetet teknike për kryerjen e këtij shërbimi.

2.3.3. Vertetim performance te leshuar nga drejtorite vendore te policise ku ndodhen objektet ku do te kryhet ky sherbim (Fier, Vlore, Berat) leshuar brenda 30 diteve nga data e hapjes se ofertave, ku te jepet informacioni i meposhtem:

- Te kete jo me pak se 110(njëqind e dhjetë) punonjes sherbimi te certifikuar nga te cilet jo me pak se 60 (gjashtdhjetë) punonjes sherbimi sipas vertetimit te leshuar nga DVP Fier, jo me pak se 25 (njëzet e pesë) punonjes sherbimi sipas vertetimit te leshuar nga DVP Vlore, jo me pak se 25 (njëzet e pesë) punonjes sherbimi sipas vertetimit te leshuar nga DVP Berat.
- Ka në funksionim Qendër Kontrolli sipas qarqeve përkatëse.
- Të ketë Grupe të gatëshme punonjesisht për verifikim të sinjaleve të alarmit pranë cdo DVP ku ndodhen objektet ku kryhet sherbimi.
- Nuk ka masë administrative per operatorin ekonomik (Subjektin) Titullarin e subjektit dhe Drejtuesin Teknik gjate periudhes janar 2020 e në vazhdim.
- Nuk ka patur ngjarje të ndodhura gjatë ushtrimit të aktivitetit, për periudhën janar 2020 e në vazhdim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41 pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e duhur te licencuar për ushtrimin e veprimtarisë në këtë fushë si dhe kanë ushtruar korrekt aktivitetin gjatë periudhës së cituar.

2.3.4. Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave per radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", me rreze mbulimi zonat ku ndodhen objektet ku do te ofrohet sherbimi (Fier, Vlore, Kucovë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", dhe shërben për të garantuar AK se ofertuesi i ka kapacitetet teknike për kryerjen e këtij shërbimi.

2.3.5. Listepagesat e shoqerise per tre muajt e fundit ku te figurojne minimalisht 110 (njëqind e dhjetë) punonjesit qe do te kryejne sherbimin si dhe drejtuesi teknik dhe administratori.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.6. Ofertuesi duhet të disponojë jo me pak se 3(tre) **automjete** për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi të shoqërisë apo të marra me qira. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Leje e Qarkullimit e automjeteve në pronësi të shoqërisë .

Në rastin kur automjeti është marrë me qira, Leja e Qarkullimit duhet të shoqërohet edhe me Kontraten noteriale të marrjes me qira, ku të jete percaktuar afati (i cili duhet të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate) dhe qellimi i marrjes me qira.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër..

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme në dispozicion për realizimin me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posaçme për objektin e prokurimit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e prokurimit: